



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

## **KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA**

---

**KPM-2012/1**

### **RREGULLORE**

### **E PUNËS SË KOMISIONIT TË PAVARUR PËR MEDIA**

## Komision i Pavarur për Media:

Në mbështetje të nenit 15.10 të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Medieve (Ligjit për KPM-në), me qëllim të përcaktimit të rregullave të organizimit, procedurave të punës dhe të funksionimit të Komisionit,

Miraton këtë:

## RREGULLORE E PUNËS SË KOMISIONIT TË PAVARUR PËR MEDIA

### KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### Rregulla 1: Dispozita të përgjithshëm

Kjo rregullore pune përcakton organizimin, procedurat e punës dhe të funksionimit të Komisionit.

#### Rregulla 2: Përkuqizimet

**Komision i Pavarur për Media:** Organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuele.

**Zyra Ekzekutive:** Organ i Komisionit të Pavarur për Media kompetent për zbatimin e të gjitha detyrat dhe përgjegjësive të përcaktuara nga KPM-ja brenda kompetencave ligjore të përcaktuara në pajtim me Ligjin e KPM-së.

#### Rregulla 3: Fillimi i punës së KPM-së

Anëtari më i vjetër i KPM-së e thërret mbledhjen e parë të KPM-së sa më parë që është e mundur, e më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e emërimit të anëtarëve të KPM-së.

#### Rregulla 4: Konstituimi i KPM-së

KPM-ja konsiderohet se është konstituuar nëse në mbledhjen e parë janë të pranishëm së paku dy të tretat (2/3) e anëtarëve të KPM-së.

#### Rregulla 5: Kuorumi i KPM-së për marrjen e vendimeve

Kuorumi i mbajtjes së mbledhjeve të KPM-së dhe e marrjes së vendimeve nga Komisioni, është pjesëmarja e së paku katër (4) anëtarëve.

#### Rregulli 6: Zgjedhja e kryetarit dhe nënkyetarit të KPM-së

Në mbledhjen e parë anëtarët e KPM-së me shumicë të thjeshtë votash, zgjedh kryetarin dhe nënkyetarin e tij nga radha e anëtarëve të KPM-së, nëse në mbledhjen e parë janë të pranishëm së paku dy të tretat (2/3) e anëtarëve të KPM-së.

Votimi për zgjedhjen e kryetarit dhe nënkyrytarit të KPM-së, bëhet me vota të fshehta. Jo më shumë se dy (2) herë, anëtarët e KPM-së, mund të propozojnë dhe votojnë kandidatin e njëjtë për kryetar dhe nënkyrytar të KPM-së.

#### **Rregulla 7: Thirrja e Mbledhjeve të KPM-së**

Kryetari i KPM-së, të paktën një herë në muaj, thërret mbledhjet e rregullta të KPM-së. Mbledhjet e KPM-së mund të caktohen edhe me kërkesën e së pakut katër (4) anëtarëve të KPM-së. Sipas nevojës mbledhjet e KPM-së mund të caktohen edhe më shpesh.

#### **Rregulla 8: Agjenda për takimet e Komisionit**

Zyra Ekzekutive në bashkëpunim me Kryetarin e Komisionit përgatit agjendën për takimet e Komisionit të cilën Zyra Ekzekutive e përcjell për komente tek anëtarët e tjerë të Komisionit. Anëtarët e Komisionit mund të propozojnë heqjen, ndryshimin si dhe shtimin e çështjeve tjera sipas vlerësimit te tyre dhe urgjencës se rasteve. Komisioni gjatë punës duhet t'i përbahet në përpikëri Agjendës së punës.

#### **Rregulla 9: Udhëheqja me punën e KPM-së**

Mbledhjet e KPM-së i udhëheq Kryetari i KPM-së në pajtim me Rregulloren e punës të KPM-së. Në mungesë të Kryetarit të KPM-së, mbledhjet i udhëheqë Nënkyrytari i KPM-së.

#### **Rregulla 10: Qasja Publikut në Mbledhjet e KPM-së**

Procesi i punës së KPM-së dhe votimi gjatë vendimmarrjes është i hapur për publikun, përderisa nuk vendoset ndryshe nga Anëtarët e Komisionit.

#### **Rregulla 11: Raportimi i KPM-së**

KPM-ja, sipas këtij ligji është i detyruar që për punën e vet t'i raportoj, themeluesit të tij, në mënyrë të rregullt dhe të jashtëzakonshme. Raportimi i rregullt i KPM-së për punën e tij, bëhet në mënyrë periodike – një (1) herë në çdo tre (3) muaj dhe në fund të çdo viti. Raportimi i jashtëzakonshëm, bëhet sipas kërkesës së themeluesit.

#### **Rregulla 12: Thirrja e Mbledhjeve të Jashtëzakonshme**

Në rast të ngritjes së ndonjë çështjeje urgjente që kërkon vëmendjen e Komisionit, Shefi Ekzekutiv i KPM-së do të kontaktoj pa vonesë Kryetarin e Komisionit. Kryetari do të vendosë nëse një mbledhje e jashtëzakonshme e Komisionit do të thirret apo nëse çështja do të kryhet duke kontaktuar anëtarët, përmes telefonit me e-mail apo ndonjë mënyrë tjeter. Nëse një çështje kërkon një vendim urgjent të Komisionit, një vendim i tillë mund të bëhet, përfshirë votimin, edhe me e-mail.

#### **Rregulla 13: Mbledhjet e veçanta**

Mbledhjet e Komisionit do të ndahanë në mbledhje për diskutim të politikave dhe çështje të ngjashme dhe seanca ekzekutive për diskutime lidhur me çështjet e licencimit, raste të shkeljes së kushteve të licencës, çështje të personelit, buxhetit si dhe çështje tjera operative.

#### **Rregulla 14: Delegimi i Përgjegjësisë tek Shefi Ekzekutiv**

Komisioni do të përcaktoj llojet e rasteve dhe kushtet nën të cilat e delegon të drejtën e marrjes së vendimeve tek Shefi Ekzekutiv. Kjo do të përfshijë rastet e thjeshta të natyrës rutinore si dhe mundësinë të zgjidhë rastet apo mbyllë rastet nëse nuk ka rrethana që këto raste të vazhdohen. Komisioni do të rishikoj delegimin e përgjegjësive së pakut një herë në vit në pajtim me nenin 16.6 të Ligjit të KPM-së. Shefi Ekzekutiv apo ndonjë anëtarë i personelit i caktuar do të prezantoj një përbledhje mbi rastet e tillë tek Komisioni në secilën mbledhje të Komisionit. Komisioni do të përcaktoj natyrën e saktë të përbledhjes së tillë.

### **Rregulla 15: Themelimi i nën-komisioneve nga ana e KPM-së**

Komisioni do të krijoj nën - komisione për çështje të veçanta dhe do t'u caktoj përgjegjësi të veçanta anëtarëve të Komisionit. Nën-Komisionet e tilla mund të takohen ndërmjet seancave të Komisionit dhe posaçërisht do të krijohen për qëllim të gjetjes së fakteve, përfshirë shqyrtimet e rasteve.

### **Rregulla 16: Vendim-marrja e Komisionit**

Në pajtim me Nenin 15.4 të ligjit të KPM-së Komisioni ka një kuorum dhe mund të merr vendime nëse së paku 50% të anëtarëve të saj janë prezent. Komisioni merr vendime me votim të shumicës së thjeshtë të atyre që janë prezent, përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Ligjin e KPM-së. Anëtarët të cilët janë prezent por abstenojnë nga votimi përfshihen në numrin e anëtarëve relevant që të përcaktoj numrin e votave të nevojshme për t'u bërë votimi. Votimi do të jetë i hapur dhe i bërë me ngritje të dorës përveç nëse ndonjë anëtarë i Komisionit kërkon votim të fshehtë me fletë-votime. Votat do të registrohen në procesverbal duke cekur numrin e votave pro dhe kundër, pa treguar se kush ka votuar si, përveç nëse një anëtarë i Komisionit vendos të shtoj një vërejtje.

Pas çdo takimi, sipas renditjes së pikave në agjendë, miratohen konkluzat dhe vendimet e takimit me nënshkrimin e të gjithë anëtarëve prezent në takim (*plotësohet Forma KPMT-A*)

### **Rregulla 17: Përjashtimi i anëtarit të KPM-së nga procesi i vendimmarrjes**

Në rast se një çështje për diskutim (me qëllim të marrjes së vendimeve) nga Komisioni, posaçërisht kur ka të bëjë me çështjet e licencimit, rastet e shkeljes së kushteve të licencës apo çështjet e personelit, përfshinë një person apo ndërmarrje me të cilën anëtarë i Komisionit ka ndonjë raport personal, anëtarë i Komisionit do të bëjë këtë raport të ditur. Komisioni do të vendos nëse anëtarë do të lirohet nga diskutimi dhe votimi lidhur me çështjen, në pajtim me Kodin Etik të KPM-së.

**Rregulla 18: Përgatitja e materialeve për mbledhjet e Komisionit nga ana e Zyrës Ekzekutive Zyra e Ekzekutive e KPM-së, nën udhëheqjen e Shefit Ekzekutiv, - është përgjegjëse për përgatitjet e mbledhjeve të Komisionit. Shefi Ekzekutiv do të caktoj një anëtar të personelit të KPM-së që të ketë përgjegjësinë kryesore për përgatitjen e mbledhjeve të Komisionit dhe për këtë person do ta njoftoj Komisionin. Shefi Ekzekutiv është përgjegjës për mbarëvajtjen e procedurës dhe orarit për përgatitjen e mbledhjes së Komisionit që iu mundëson anëtarëve të Komisionit të marrin materialin e përgatitur dhe rendin e ditës të propozuar së paku pesë ditë para mbledhjes se Komisionit përveç nëse ekzistojnë arsyë të jashtëzakonshme.**

Shefi Ekzekutiv i KPM-së dhe personeli tjeter të cilin ai/ajo e përcakton do të jetë prezent në mbledhjet e Komisionit. Komisioni do të vendosë kohë pas kohe se deri në çfarë mase personeli tjeter do të jenë të pranishëm në seancat ekzekutive të Komisionit.

### **Rregulla 19: Përgatitja e Rasteve me Rekomandime nga Zyra Ekzekutive**

Shefi Ekzekutiv është përgjegjës për përgatitjen e rasteve për mbledhjen e Komisionit, përfshirë rastet e licencimit, rastet e shkeljes se kushteve të licencës dhe çfarëdo lloji tjeter të rasteve sipas ligjit të KPM-së apo ndonjë ligji tjeter të aplikueshëm. Shefi Ekzekutiv u delegon drejtoreve të Departamenteve gjegjëse të Zyrës Ekzekutive detyrat dhe përgjegjësitë për përgatitjet e rasteve të caktuara (ligjore, të licencimit, menaxhimit frekuencor, të monitorimit dhe analizës së mediave dhe të administratës) me rekomandime.

Komisioni do të lëshoj udhëzime për atë se kur janë të nevojshme seancat dëgjimore për rastet. Shefi Ekzekutiv do të aranzhoj seancat dëgjimore në pajtueshmëri me këto udhëzime.

### **Rregulla 20: Regjistrimet e Mbledhjeve të Komisionit**

Shefi Ekzekutiv do të caktoj një anëtarë të personelit përgjegjës për mbajtjen e shënimeve (regjistrimeve) të vendimeve të marra në mbledhjet e Komisionit. Brenda një jave pas takimit të Komisionit, procesverbal i përgatitur nga Zyra Ekzekutive u përcillet anëtarëve me email për komentet e tyre. Anëtarët e Komisionit të cilët kanë votuar kundër shumicës për çështjen e cila është hedhur në votim, nëse dëshirojnë mund të shtojnë sqarimet apo kundër argumentet në procesverbal.

Në takimin e radhës, procesverbal nga takimi paraprak miratohet dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët Komisionit pjesëmarrës në takimin paraprak.

### **Rregulla 21: Pjesëmarrja Publike në Hartimin e akteve nënligjore**

Çfarëdo propozimi për rregullore, kode dhe udhëzues të miratuara nga Komisioni do të ndahen me grupet e interesit dhe publikut për diskutim.

### **Rregulla 22: Kompensimi i Komisionit**

Niveli i kompensimit të kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së, caktohet në pajtim me Ligjin për pagat e zyrtarëve të lartë.

### **Rregulla 23: Ndryshimi i Rregullores**

Kjo rregullore mund të ndryshohet në çdo kohë në pajtim me Ligjin dhe me shumicën e votave të anëtarëve të KPM-së.

### **Rregulli 24: Hyrja në Fuqi**

Rregullorja e punës së KPM-së hyn në fuqi në ditën kur miratohet nga KPM-ja.

Kryetari i KPM-së

Shefki UKAJ

Data:

18.09.2012

